



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**Anr.254/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Nenad Laziq dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Prizren, për shkak të dëmtimit të posterave, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.06.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**HEDHET** si e pa rregullt ankesa e Koalicionit PDK-AAK), dega në Prizren, me numër të ankesës Anr.254 të datës 12.06.2017

## A r s y e t i m

Me datën 12.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nëpërmjet postës nga Koalicioni PDK-AAK, në të cilën pretendon se është bërë dëmtimi i billbordave të kandidatëve të PDK-së në Prizren deh me këtë rast është bërë shkelja e dispozitave ligjore mbi zgjedhjen e përgjithshme në Republikën e Kosovës. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur dy fotografi dhe ka theksuar se pas identifikimit të personave nga ana e Policisë së Kosovës, dega e PDK-së dhe kërkon që organi kompetent të bie vendim meritor ndaj personave përgjegjës.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të ankesave gjeti se:


### **Ankesa është e pa rregulltë**

PZAP-i, vlerësoi nga shkresat e lëndës se ankesa është e parregullt sepse parashtruesi i ankesës nuk e ka specifikuar se kush mund të jetë kryerësi i supozuar i shkeljeve të pretenduar në ankesë siç kërkohet në bazë të nenin 6.3 të Rregullave dhe procedurave të PZAP-it.

Prandaj PZAP-i, nuk u lëshua fare në shqyrtimin e kësaj çështje, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartëtheksuar andaj bazuar na dispozitat e theksuar më lart si dhe në arsyet e sipërshënuar po ashtu në kuptim të nenit 5.7 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.254/2017 më datën 12.06.2017.



**Kryesuesi i Panelit**

**Faton Ademi**

**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*